# DËSHMI ARKIVI

**A-474904**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Irlanda e fiton bindshëm ndeshjen që nuk e deshi |
| ADRESA | `https://www.koha.net/futboll/irlanda-me-epersi-bindese-ne-ndeshjen-e-shumepritur` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 01:15:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 19:14:32 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1eda2805360c121e96c70f604ecc00782800e4797b60112205c418e6645f7868` |
| TEKSTI | `caaf89e666f1c3c04be1e84ee582f2c0c06761b7ea34a8da62eafd74bfd9c839` |
| PAMJA | `88bf5fdc0423405be8d8536edd0e457b27add109d22db83ee2eff703781aff11` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `410c18cba224bad77cd5834f9318eb02306dc02136f2749fd0400a3c7cec72bf` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `ab3276ac2cb522ea05a9b9eebe99b70422c74012061c3bc349b5122226e7063e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/410c18cba224bad77cd5834f9318eb02306dc02136f2749fd0400a3c7cec72bf`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

FUTBOLL

# Irlanda e fiton bindshëm ndeshjen që nuk e deshi




27 shtator 2026 21:14

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Irlanda nuk deshi të luante ndaj Izraelit, ashtu siç u raportua për periudhë të gjatë. Por, të dielën megjithatë luajti, dhe fitoi bindshëm në ndeshjen e dytë të Ligës B3 të Ligës së Kombeve. Duelin që e luajti në udhëtim tek Izraeli në Debrecen të Hungarisë, Irlanda e fitoi 3:0.

Golat e fitores që u vendos në pjesën e parë, i shënuan Troy Parrot, Adam Idah dhe Jack Moylan.
Gjatë intonimit të himnit të Izraelit, gjithë lojtarët dhe delegacioni i Irlandës e mbajtën kokën ulur me ngjarjet që po ndodhin në Gaza. Irlanda është në përkahje të madhe të Palestinës.

Kapiteni Dara O'Shea nuk ia dha dorën fare kapitenit të Izraelit para nisjes së ndeshjes, kur u caktuan anët e përfaqësueseve dhe kush e nis ndeshjen pari.

Gjithë lojtarët e Irlandës në këtë ndeshje mbajtën shirit të zi në krah, në shenjë përkrahjeje për Gazan.

Irlanda e humbi ndeshjen e parë në Prishtinë nga Kosova, 1:0.
Izraeli e pësoi humbjen e dytë, pas asaj nga Austria, 3:1.
Austria ka 6 pikë në vendin e parë, ndërsa tri i ka Kosova në vendin e dytë, sa ka edhe Irlanda në vendin e tretë.
Izraeli është i fundit, pa pikë.

Edhe



Futboll • 26 sht 2026
Ndeshja Izraeli – Irlanda do të luhet, vendosën "votat e lojtarëve"

**Irlanda me epërsi bindëse në ndeshjen e shumëpritur**

Irlanda ka krijuar epërsi bindëse në ndeshjen që pati zhvillime të shumta ditët e kaluara.

Irlandëzët janë duke fituar 3:0 pas 25 minutave lojë ndaj Izraelit, në kuadër të Grupit B3.

Troy Parrot në minutën e 13-të, Adam Idah në minutën e 16-të

**Futboll.**
Portugalia mposht Norvegjinë, Ronaldo nuk luan

**Showbiz.**
Dua Lipa nga vendlindja: Patëm dasmë të madhe shqiptare, po na rritet rrethi

**Futboll.**
Kloppi pëson humbjen e parë me Gjermaninë

**Sporte të tjera.**
Dramë në Ferizaj, Kastrioti e fiton Superkupën për herë të parë

**Arbëri.**
Nata e 12-të e protestës "Jo në emrin tim", në Gjakovë protestës iu bashkua Nënë Ferdonija

**Basketboll.**
Bora ia shkakton Yllit humbjen e dytë

dhe Jack Moylan në minutën e 25-të, shënuan për 3:0.

Ndeshja po luhet në Debrecen, ndërsa Izraeli është vendës.

U fol shumë se Irlanda mund ta bojkotonte këtë ballafaqim. Por në fund, lojtarët votuan që dueli të luhet. Në Irlandë ka përkrahje të madhe për Palestinën. Dhe janë kundër situatës në Gaza.


Edhe



**Futboll** • 18 sht 2026

Irlanda e luan ndeshjen e radhës me Kosovën, por diskutimet janë për atë me Izraelin


Para se të niste ndeshja, irlandezët nuk ua dhanë dorën lojtarëve izraelitë.

Kapiteni i Irlandës, Dara O'Shea i mbajti duart prapa, teksa gjyqtari e hodhi monedhën për t'i caktuar anët e ekipeve dhe kush e nis ndeshjen.

Lojtarët kanë mbajtur shirita të zinj në krah, ndërsa gjatë intonimit të himnit të Izraelit, gjithë 11-shja e Irlandës e mbajti kokën poshtë.

Irlanda e humbi ndeshjen e parë 1:0 nga Kosova në Prishtinë të enjten. Të enjten, Izraeli u mposht 3:1 nga Austria.

Pathetic and embarrassing Ireland team with black armbands and heads down for the Israeli National anthem pic.twitter.com/83Gxoynorb

— Ann McElhinney 🧡 (@annmcelhinney) September 27, 2026


Edhe



**Futboll** • 16 o. më parë

Bazunu, irlandezi që nuk pranoi të luajë kundër Izraelit


Ireland refused to shake hands with Israel tonight and wore black armbands for the lives lost.

Gavin Bazunu went further and withdrew from the squad rather than play.

Bravo Ireland 👏👏👏 pic.twitter.com/071dUzEYSR

— Vigi | Football Analyst (@FootballByVigi) September 27, 2026

#IRLANDA


## Artikuj të ngjashëm



**Futboll** • 26 sht 2026

Zhvillime të reja, Irlanda nuk dëshiron të luajë ndaj Izraelit



**Futboll** • 26 sht 2026

Irlanda shtyn konferencën për media para duelit me Izraelin



Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të

Marketing

mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.



Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë



Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.